



MINISTRIA E EKONOMISË  
KULTURËS DHE INOVACIONIT  
Nr. 2594/3 Prot.  
Date, me 12.3.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 162, datë 12.3.2025

PËR

**DEKLARIMIN “PASURI KULTURORE E PALUAJTSHEME”**  
**TË ZONAVE ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË QYTETIT**  
**TË LEZHËS, MIRATIMIN E ZONIFIKIMIT DHE TË PLANIT**  
**PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN**  
**E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 3, shkronjat “a” dhe “ç”, 53, pika 3, shkronja “b”, nënndarja “iv”, e 62, pika 3, të ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin “pasuri kulturore e paluajtshme” të zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Lezhës, sipas hartës së zonifikimit dhe koordinatave gjeografike, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me ligjin nr.111/2018, “Për kadastrën”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
4. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartat e qendrës historike dhe zonës mbrojtëse në Gjeoportalin Kombëtar.

5. Vendimi nr.728, datë 1.9.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Lezhës dhe miratimin e rregullores së administrimit”, shfuqizohet.
6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

## **K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**

MINISTRI I EKONOMISË,  
KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

## PLANI

### PËR

#### RUAJTIJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E ZONAVE ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË QYTETIT TË LEZHËS

##### Neni 1 Qëllimi

1. Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Lezhës, si dhe përcaktimin e kufijve të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.
2. Objektivat kryesorë të këtij plani janë:
  - a) ruajtja, mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave të trashëgimisë kulturore, arkeologjike dhe të peizazhit të zonave arkeologjike “A” dhe “B”;
  - b) administrimi i zonave arkeologjike “A” dhe “B”;
  - c) mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve të specializuara, të ngarkuara për ruajtjen, mbrojtjen, restaurimin dhe miradimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit të Lezhës, me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

##### Neni 2 Hapësira urbane arkeologjike në mbrojtje

1. Hapësira urbane me vlera arkeologjike, historike dhe kulturore e qytetit të Lezhës, pjesë e trashëgimisë kulturore, përbëhet nga:
  - a) zona arkeologjike “A”;
  - b) zona arkeologjike “B”.
2. Kufijtë e zonave arkeologjike “A” dhe “B” paraqiten në hartat e zonimit të qytetit të Lezhës, me koordinatat në sistemin referues gjeodezik zyrtar - KRGJSH, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Hartimi dhe miratimi i instrumenteve të planifikimit urban të qytetit të Lezhës merr në konsideratë kufijtë e zonimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Lezhës, si dhe planin për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.

##### Neni 3 Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Lezhës

1. Në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Lezhës lejohet vetëm:

- a) mirëmbajtja, restaurimi dhe konservimi i integruar i monumenteve të kulturës dhe strukturave arkeologjike, pas shqyrtimit dhe miratimit të projekteve nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim, "KTKM");
- b) kryerja e formave të testimit, të tilla si: sondazhe që nuk cenojnë shtresat arkeologjike, hulumtime arkeologjike parandaluese dhe të shpëtimit, studime gjeofizike, regjistrim digjital i terrenit, të përcaktuara me vendim të KTKM-së;
- c) zbatimi i projekteve kërkimore-shkencore të miratuara nga struktura përgjegjëse për miratimin e projekteve kërkimore-shkencore pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KTKM-ja;
- ç) rikonstruksioni i rrugëve dhe i të gjitha punimeve në rrjetin inxhinierik mbi bazën e projekteve të miratuara nga KTKM-ja;
- d) rikonstruksioni/rindërtimi i godinave ekzistuese pa ndryshim të gjurmës, volumi i përgjithshëm i të cilave nuk cenon pasuritë kulturore të nëntokës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga KTKM-ja;
- dh) vendosja e konstruksioneve të lehta të përkohshme (dru, xham, plastikë, metal) me lartësi maksimale 1 kat, në funksion të informimit publik, që lidhen me veprimtarinë arkeologjike, trashëgiminë kulturore, si dhe nevojave të tjera të rikualifikimit urban të zonës, si më poshtë vijon:
  - i. Konstruksionet duhet të janë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin;
  - ii. Projekti për vendosjen e konstruksioneve të lehta miratohet nga KTKM-ja dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen dhe vendndodhjen e strukturës;
  - iii. Vendosja e tyre duhet të bëhet nën mbikëqyrjen e institucioneve shtetërore të specializuara.
- 2. Projekti për strukturat e përmendura në shkronjën "dh", të pikës 1, këtij nen, miratohet nga KTKM-ja dhe, për çdo rast, duhet të përcaktajë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës, si dhe planprojektin e saj. Projektet lidhur me ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike "A" të qytetit të Lezhës, të parashikuara në shkronjat "ç", "d" dhe "dh", të pikës 1, të këtij nen, shqyrtohen e miratohen nga KTKM-ja dhe më pas vijojnë procedurën sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

#### **Neni 4** **Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Lezhës**

1. Në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Lezhës, përveç ndërhyrjeve që lejohen në zonën arkeologjike "A", lejohen edhe ndërtimet e reja pas miratimit nga KTKM-ja.
2. Projektet për ndërtimet e reja shqyrtohen e miratohen nga KTKM-ja dhe vijojnë procedurën, sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

3. Ndërtimet e reja lejohen vetëm pas kryerjes së formave të testimit, të përcaktuara nga KTKM-ja, në varësi të potentialit arkeologjik, që përfaqëson zona.
4. Gërmimi arkeologjik kryhet sipas përcaktiveve të KTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku, në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.

#### **Neni 5** **Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet e lejuara në zonat arkeologjike**

1. Për ndërhyrjet e lejuara në zonat arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Lezhës, projektet shqyrtohen e miratohen në KTKM, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 80 të ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pas aplikimit nëpërmjet portalit unik qeveritar "*e-Albania*".
2. Për çdo rast, KTKM-ja shqyrton dhe vodos për kryerjen ose jo të formave të testimit. Testimet kryhen nga institucionë shtetërore të specializuara dhe/ose subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike. Shpenzimet për kryerjen e formave të testimit mbulohen nga investitori.
3. Testimet e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 3, të këtij plani, kryhen sipas përcaktiveve të KTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku, në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim, IKTK).
4. Për ndërhyrjet e parashikuara në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 1, të nenit 3, të këtij plani, përpara zbatimit të tyre, me miratim të KTKM-së, nga subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike ose institucionet e specializuara shtetërore realizohen:
  - a) format e testimit sipas shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 3, të këtij plani, të mbikëqyrura nga institucionet shtetërore të specializuara;
  - b) monitorimi arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara dhe/ose institucionë shtetërore të specializuara.
5. Për të gjitha ndërhyrjet në zonat arkeologjike realizohet monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike dhe/ose institucionë shtetërore të specializuara dhe mbikëqyrje arkeologjike nga institucionet e specializuara shtetërore.
6. Ndërtimet pa leje, të ndodhura brenda kufirit të zonave arkeologjike "A" dhe "B", trajtohen në përputhje me ligjin nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Shprehja e autoritetave të trashëgimisë kulturore është kusht për përfundimin e procedurave të legalizimit për të gjitha rastet e specifikuara shprehimisht në ligj.

**Neni 6**  
**Procedura që ndiqet në rast ndërhyrjesh të paautorizuara në zonat arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Lezhës**

1. Në rast konstatimi ndërhyrjesh të paautorizuara brenda zonave arkeologjike “A” dhe “B”, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për qytetin e Lezhës, ka detyrimin të ndërpresë menjëherë veprimitarë e subjektit nëpërmjet aktit të konstatimit.
2. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për qytetin e Lezhës, njofton menjëherë IKTK-në, institucionin kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionin kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, si dhe strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.
3. Në rast se subjekti nuk ndërpërt veprimet menjëherë, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për qytetin e Lezhës, i drejtohet menjëherë institucionit kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionit kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, për marrjen e masave përkatëse në zbatim të ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

**Neni 7**  
**Gjetjet rastësore arkeologjike**

1. Klasifikohen si gjetje rastësore arkeologjike objektet e luajtshme dhe të paluajtshme në kontekstet e tyre arkeologjike dhe strukturat arkitektonike, sipas parashikimeve të ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.
2. Në rast gjetjesh rastësore arkeologjike gjatë zbatimit të punimeve në zonat arkeologjike, punimet pezullohen menjëherë, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 145, të ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.
3. Në varësi të vlerave që përbajnë gjetjet rastësore arkeologjike, KKTKM-ja shprehet për procedurën dhe hulumtimet arkeologjike të nevojshme për ruajtjen e mbrojtjen e tyre.
4. Për çdo rast, veprimitaria arkeologjike realizohet sipas parashikimeve të neneve 139, 145, 146, 147, 260, të ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

**Neni 8**  
**Vendosja e tabelave prezantuese dhe e paneleve shpjeguese**

1. Në zonat arkeologjike “A” dhe “B” lejohet vendosja e tabelave prezantuese dhe e paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik, pas shqyrtimit e miratimit nga KKTKM-ja.

2. Në asnjë rast, tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo të konkurrojnë pamjen, peizazhin dhe integritetin e monumentet, dëshmitë dhe gjetjet arkeologjike.
3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë monumenteve dhe zonave të mbrojtura rrreth tyre, dëshmive dhe gjetjeve arkeologjike bëhet nën mbikëqyrjen e DRTK-së, përgjegjëse për qytetin e Lezhës, pas njoftimit zyrtar nga Bashkia Lezhë.
4. Është e ndaluar vendosja e posterave apo e mjeteve të tjera reklamuese, si dhe dëmtimet e tjera (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme) të monumenteve dhe trënojave arkeologjike.

**Neni 9**  
**Trajtimi i rasteve të paparashikuara**

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë plan, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet institucioneve të specializuara.

## ANEKS NR.1

### KOORDINATAT E ZONËS ARKEOLOGJIKE “A” TË QYTETIT TË LEZHËS (KRGJSH 2010)

NR.	E	N
1	471048	4627787
2	471062.3	4627757
3	471087	4627730
4	471100.1	4627720
5	471119.7	4627715
6	471161.9	4627706
7	471215.6	4627689
8	471246.3	4627690
9	471269.3	4627686
10	471290.9	4627679
11	471307.1	4627668
12	471315.7	4627658
13	471304.8	4627637
14	471275.8	4627628
15	471252.8	4627625
16	471224.1	4627637
17	471199	4627633
18	471186.6	4627636
19	471169.6	4627635
20	471145	4627636
21	471129.3	4627646
22	471121.4	4627660
23	471111.5	4627669
24	471098.1	4627667
25	471083.9	4627658
26	471082	4627612
27	471062.9	4627595
28	471046.9	4627583
29	471065.2	4627581
30	471075.6	4627576
31	471079.2	4627558
32	471086.3	4627542
33	471078.6	4627518
34	471082.5	4627506
35	471071	4627489
36	471076.3	4627444

37	471040.6	4627441
38	471019.2	4627437
39	470992.9	4627426
40	470965.7	4627419
41	470954.1	4627412
42	470940.5	4627374
43	470926	4627352
44	470892.9	4627328
45	470876.6	4627295
46	470866.6	4627295
47	470857	4627296
48	470851.6	4627307
49	470832.6	4627327
50	470795.2	4627355
51	470778.7	4627360
52	470770.6	4627351
53	470759	4627347
54	470746.1	4627318
55	470738	4627293
56	470734.5	4627274
57	470714.4	4627267
58	470671	4627268
59	470642	4627216
60	470538.8	4627277
61	470512.4	4627296
62	470503.1	4627298
63	470434.7	4627309
64	470383.3	4627312
65	470359.2	4627314
66	470309.5	4627314
67	470274.5	4627310
68	470252.9	4627404
69	470249	4627428
70	470244	4627461
71	470236.8	4627491
72	470230.2	4627529
73	470216.9	4627569
74	470210.9	4627589
75	470180.3	4627669
76	470175	4627688
77	470174.4	4627705
78	470179.3	4627723

79	470188	4627740
80	470197.6	4627753
81	470229.9	4627792
82	470258.3	4627813
83	470270.7	4627819
84	470272.8	4627818
85	470293.3	4627826
86	470311.1	4627839
87	470340.5	4627877
88	470377.6	4627851
89	470387.7	4627868
90	470415.3	4627858
91	470413.5	4627856
92	470437.1	4627848
93	470446.5	4627841
94	470457.9	4627857
95	470470.5	4627846
96	470478.9	4627831
97	470495.6	4627827
98	470518.3	4627807
99	470533.7	4627804
100	470536.8	4627810
101	470591.4	4627783
102	470601.4	4627810
103	470624.4	4627834
104	470639.4	4627840
105	470639.8	4627855
106	470657.5	4627882
107	470677.4	4627894
108	470697.3	4627914
109	470706.4	4627927
110	470711.8	4627944
111	470724.4	4627957
112	470742.6	4627959
113	470761.4	4627960
114	470794.5	4627934
115	470798.4	4627937
116	470840.8	4627889
117	470871.6	4627923
118	470925	4627932
119	470930.4	4627878
120	470919.9	4627826

121	471009.7	4627799
122	471022.8	4627796
123	471047.4	4627794
124	471048	4627787

**ANEKS NR.2****KOORDINATAT E ZONËS ARKEOLOGJIKE “B” TË QYTETIT TË LEZHËS  
(KRGJSH 2010)**

Nr.	E	N
1	471323.7	4627703
2	471333.1	4627698
3	471343.8	4627687
4	471376.7	4627648
5	471374.2	4627556
6	471337.6	4627532
7	471316.2	4627510
8	471292.4	4627474
9	471260.4	4627463
10	471254.6	4627428
11	471247.9	4627409
12	471223.5	4627396
13	471205.9	4627366
14	471178.4	4627331
15	471168.7	4627302
16	471153.6	4627278
17	471145.1	4627241
18	471128.2	4627236
19	471113.1	4627229
20	471098.7	4627227
21	471091.8	4627233
22	471091.8	4627251
23	471088.1	4627262
24	471056.4	4627293
25	471034.7	4627286
26	471024.7	4627272
27	471007.5	4627260
28	470998.4	4627257
29	470946.6	4627310
30	470885.9	4627281
31	470865.5	4627274
32	470848.2	4627266
33	470827	4627247
34	470802.4	4627268
35	470787.8	4627248
36	470784.8	4627236
37	470772.4	4627210
38	470795.6	4627195
39	470814.3	4627153

40	470795.2	4627125
41	470705.9	4627178
42	470634.4	4627076
43	470511.1	4627122
44	470381.5	4627120
45	470374	4627184
46	470287.5	4627178
47	470274.5	4627310
48	470252.9	4627404
49	470249	4627428
50	470244	4627461
51	470236.8	4627491
52	470230.2	4627529
53	470216.9	4627569
54	470210.9	4627589
55	470180.3	4627669
56	470175	4627688
57	470174.4	4627705
58	470179.3	4627723
59	470188	4627740
60	470197.6	4627753
61	470229.9	4627792
62	470258.3	4627813
63	470270.7	4627819
64	470272.8	4627818
65	470293.3	4627826
66	470311.1	4627839
67	470340.5	4627877
68	470375	4627937
69	470397.3	4627998
70	470400.8	4628065
71	470437.5	4628056
72	470451.7	4628041
73	470468.7	4628034
74	470480.5	4628019
75	470490	4628009
76	470504.5	4627996
77	470524.1	4628004
78	470545	4628009
79	470562.6	4628009
80	470572.6	4628018
81	470595.4	4628045
82	470605	4628074
83	470614.7	4628102

84	470624.2	4628118
85	470646.5	4628130
86	470705	4628145
87	470719.4	4628085
88	470765.8	4628050
89	470785.4	4628062
90	470810.7	4628070
91	470835.4	4628073
92	470860.7	4628081
93	470883.2	4628077
94	470906.2	4628085
95	470926	4628110
96	470934.8	4628104
97	470946.4	4628108
98	470958.7	4628108
99	470978.4	4628099
100	470994.5	4628081
101	471002.7	4627982
102	471008	4627979
103	471015.7	4627951
104	471019	4627923
105	471027.3	4627886
106	471009.7	4627799
107	471022.8	4627796
108	471047.4	4627794
109	471056.8	4627793
110	471080.2	4627783
111	471089.9	4627782
112	471127.5	4627754
113	471148.7	4627750
114	471168.2	4627747
115	471187.6	4627739
116	471201.8	4627737
117	471252.7	4627729
118	471296.9	4627720
119	471316.4	4627712
120	471323.7	4627703

### ANEKS NR.3



NR.PROT. 1331/1  
DATË 12.3. 2025

MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE  
INOVACIONIT  
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BASHKISË LEZHË  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

**Në mungesë dhe me porosi**

**Herald JONUZAJ**

